VENDIM
Nr.445, datë 9.7.2004

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHKOLLAVE PASUNIVERSITARE (SHPU) TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 38 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e shkollimit në shkollat pasuniversitare (SHPU), pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, në degët inxhinieri ndërtimi e përgjithshme, inxhinieri mjedisi, inxhinieri hidroteknike, inxhinieri gjeodezi dhe pranë fakulteteve të tjera të Universitetit Politeknik të Tiranës, të jenë si më poshtë vijojnë:

- Për pasuniversitarët nga personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm i shkollave të larta publike:	75 000 (shtatëdhjet e pesë mijë) lekë;
- Për pasuniversitarët e tjerë:	100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Institucionet organizuese të shkollave pasuniversitare (SHPU) t'i administrojnë të ardhurat që mbledhin, sipas ligjit nr.8379, datë 19.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano